

Sektori i veprave civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 68 nga Rregullorja gjyqësore ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.66/2013 dhe 114/2014) dhe nenit 33 nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.14/2022), duke vepruar mbi konkluzionin e sektorëve civil të katër gjykatave të apelit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për diskutimin e çështjes juridike për sigurimin e zbatimit unik të ligjit dhe harmonizimin e praktikës gjyqësore, në seancën e mbajtur më 26.12.2022, miratoi këtë:

MENDIM JURIDIK

Kryetari i Gjykatës Themelore, në rajonin e të cilit zbatohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në para ndaj Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe organeve të saj, njësite të pushtetit lokal dhe ndërmarrjeve publike është i autorizuar të përcaktojë se cilat mjete që gjinden në llogaritë e tyre të bartësit e qarkullimit pagesor, janë të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së tyre.

A r s y e t i m

Në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut – në Sektorin e veprave civile është dorëzuar konkluzion nga takimi i punës së sektorëve civil të katër gjykatave të apelit të mbajtur më 06.10.2021, me të cilin për shkak të praktikës së ndryshme gjyqësore të këtyre gjykatave, është kërkuar që Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, të prononcohet mbi çështjen juridike vallë kur në rastin e urdhër përmbarimit të miratuar në bazë të nenit 210 të Ligjit për përmbarim, kur urdhër përmbarimet e ngarkojnë llogarinë e thesarit, kryetari i gjykatës, duke vepruar mbi kërkesën për përcaktimin e mjeteve minimale për kryerjen e veprimtarisë së debitorit, ka të drejtë ta zbatojë dispozitën e nenit 218 të Ligjit për përmbarim, që ka të bëjë me përmbarimin mbi sende të tundshme dhe të drejta ndaj Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe organeve të saj, njësite të pushtetit lokal dhe ndërmarrjeve publike, dhe të caktojë limit për përmbarimin ndaj mjeteve me para në llogarinë e debitorit në llogaritë e thesarit, përkatësisht të debitorit që gjendet në kuadër të llogarive të thesarit.

Sektori i veprave civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke diskutuar mbi çështjen juridike e miratoi mendimin juridik, për këto arsye:

Sipas nenit 208 të Ligjit për përmbarim, përmbarim për shkak të realizimit të kërkesës me para ndaj personit juridik, mund të zbatohet mbi të gjitha mjetet në dispozicion të llogarive të tij pranë bartësve të qarkullimit pagesor, atje ku debitori ka llogari.

Sipas nenit 210 paragrafi (1) përmbaruesi, me urdhër përmbarim, e emëron njërin nga bartësit e qarkullimit pagesor ku mbahen mjetet në para të kreditorit dhe të debitorit, numri i llogarisë së kreditorit dhe të debitorit dhe nën llogaritë e tyre në qoftë se ekzistojnë, numri tatimor ose NUAQ i kreditorit dhe i debitorit dhe shuma e borxhit. (2) Me urdhër përmbarim mbi mjetet në para që mbahen në llogarinë e debitorit të bartësi i qarkullimit pagesor, bartësi i urdhërohet që shumën në para për të cilën është urdhëruar përmbarimi, ta transferojë prej llogarive të debitorit në llogarinë e përmbaruesit, të paraparë në nenin 36, paragrafin (5) të këtij ligji. (3) Urdhër përmbarimet, të cilat e ngarkojnë llogarinë e thesarit, përkatësisht llogarinë e debitorit e cila gjendet në suazat e llogarisë të thesarit, bartësi i qarkullimit pagesor i përmbaron në atë mënyrë që në bazë të urdhër përmbarimeve përgatit urdhëresa të cilat ia dërgon Thesarit pranë Ministrisë së Financave ku debitori i mbahet llogaria. (4) Thesari pranë Ministrisë së Financave, përkatësisht Thesarit të Fondit për

Sigurimin Shëndetësor urdhëresat nga paragrafi (3) i këtij neni i përmbaron në përputhje me këtë ligj dhe në përputhje me rregullat e qarkullimit pagesor. (5) Përmbaruesi është i detyruar ta dorëzojë urdhër përmbarimin te debitori, pasi urdhër përmbarimi mbi mjetet e llogarisë së debitorit është evidentuar te bartësi i qarkullimit pagesor.

Në nenin 218 paragrafi (1) të Ligjit për përmbarim është përcaktuar se, mbi sende dhe të drejta të Republikës së Maqedonisë dhe organeve të saj, njërive të pushtetit lokal dhe ndërmarrjeve publike, nuk mund të zbatohet përmbarim për arkëtim të kërkesave me para, në qoftë se ato janë të domosdoshme për kryerjen e veprimtarisë së tyre respektivisht detyrave. Sipas paragrafit (2) cilat sende dhe të drejta janë të domosdoshme për kryerjen e veprimtarisë dhe detyrave të debitorit, do të përcaktojë kryetari i gjyqit në rajonin e të cilit zbatohet veprimi përmbarues, nëse gjatë zbatimit të përmbarimit, palët për atë çështje nuk pajtohen ose ndryshe theksohet kjo si nevojë.

Duke u nisur nga përmbajtja e dispozitave të theksuara nga Ligji për përmbarim mund të përfundohet se kryetari i gjykatës në rajonin e të cilit zbatohet përmbarimi është i autorizuar në përputhje me nenin 218 paragrafi (1) dhe (2) të Ligjit për përmbarim të përcaktojë se cilat lëndë janë të domosdoshme për kryerjen e veprimtarisë së subjekteve - personave juridik të theksuar në të njëjtën dispozitë nga një përmbarues kompetent është emëruar bartësi i qarkullimit pagesor, që shumën në para për të cilën duhet të transferohet nga llogaria e debitorit në llogarinë e përmbaruesit dhe mënyrën e përmbarimit të urdhrit të bartësit të qarkullimit pagesor.

Në fakt, në suaza të kësaj çështjeje juridike Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes sentencës me nr. 71, faqja 225, të publikuar në Përmbledhjen e vendimeve 2001 – 2004, libri X, ka shprehur qëndrim juridik si vijon:

Para miratimit të aktvendimit me propozimin për përmbarim ndaj mjeteve të tundshme të Republikës së Maqedonisë, gjykata duhet të konstatojë nëse ato mjete janë të domosdoshme për kryerjen e detyrave të tyre themelore.

Për atë shkak, me vet faktin që përmbaruesi, urdhër përmbarimin ndaj mjeteve në para që mbahen në llogarinë e debitorit te bartësi i qarkullimit pagesor e ka vendosur sipas nenit 210 të Ligjit për përmbarim, nuk do të thotë se përmbarimi mund të zbatohet edhe në bazë të mjeteve në para të cilat janë të domosdoshme për kryerjen e veprimtarisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe organeve të saj, njërive të pushtetit lokal dhe ndërmarrjeve publike dhe se kryetari i gjykatës në rajonin e të cilit zbatohet përmbarimi nuk është i autorizuar sipas nenit 218 të Ligjit për përmbarim që të përcaktojë se cilat mjete janë ato mjete.

GJYKATA SUPREME
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Sektori i veprave civile